<p>përkatësisë kombëtare, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike.</p> <p>2. Përfitimet nga paragrafi 1, nuk do të mund të kërkohen nga një refugjat për të cilin ka arsye të forta të mendohet se ai paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës apo i cili duke qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për një krim veçanërisht të rëndë, paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Në raste nga paragrafi 2 i këtij neni, revokohet ose refuzohet leja e qëndrimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Nevoja e mbrojtjes ndërkombëtare që lind <i>sur place</i></p> <p>1. Frika e bazuar mirë për persekutim apo rreziku real i përjetimit të cenimit serioz mund të bazohet në ngjarjet të cilat kishin ndodhur që nga koha kur aplikuesi kishte lëshuar vendin e origjinës.</p> <p>2. Frika e bazuar mirë për persekutim apo rreziku real i përjetimit të cenimit serioz mund të bazohet në aktivitetet në të cilat</p>	<p>be threatened on account of his race, religion, nationality, membership of a particular social group or political opinion.</p> <p>2. The benefit from the paragraph 1 of this article may not, however, be claimed by a refugee for whom there are reasonable grounds for regarding as a danger to the security of the Republic of Kosovo, or who, having been convicted by a final judgment of a particularly serious crime, constitutes a danger to the community of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. In cases in paragraph 2 of this Article, the residence permit will be revoked or refused.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 International protection needs arising <i>sur place</i></p> <p>1. A well-founded fear of being persecuted or a real risk of suffering serious harm may be based on events which have taken place since the asylum seekers left the country of origin.</p> <p>2. A well-founded fear of being persecuted or a real risk of suffering serious harm may be based on activities</p>	<p>ugrožava zbog razloga rase, vere, nacionalne pripadnosti, članstva u određenoj društvenoj grupi ili političkih uverenja.</p> <p>2. Koristi iz stava 1 ne može se zahtevati od strane izbeglice o kome ima jake razloge da se veruje da on predstavlja opasnost za bezbednost Republike Kosove ili koji je osuđen pravosnažnom odlukom za ozbiljan zločin, predstavlja rizik za bezbednost zajednice Republike Kosove. .</p> <p>3. U slučajevima iz stava 2 ovog Člana, boravišna dozvola će biti oduzeta ili odbijena.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Potreba za međunarodnu zaštitu koja nastane (<i>sur place</i>)</p> <p>1. Osnovani strah za realnu opasnost od ozbiljne štete može da se zasniva na događajima koji su se odigrali kada je tražioc napustio zemlju porekla.</p> <p>2. Osnovani strah za realnu opasnost od ozbiljne štete može da se zasniva na</p>
--	--	--



<p>azilkërkuesi ishte angazhuar që nga koha e lëshimit të vendit të origjinës, në veçanti kur konstatohet që aktivitetet në fjalë paraqesin shprehje dhe vazhdimësi të dënimeve apo orientimeve që mbizotërojnë në vendin e origjinës.</p> <p>3. Pa e cenuar Konventën e Gjenevës, Republika e Kosovës mund të përcaktojë se azilkërkuesi i cili parashton një kërkesë pasuese zakonisht nuk do të akordohet me statusin e refugjatit, nëse rreziku i persekutimit është i bazuar në rrethanat të cilat aplikuesi i kishte krijuar me vendimin e vet që nga koha e lëshimit të vendit të origjinës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Njohja e azilit</p> <p>1. Republika e Kosovës iu jep azilin shtetasit të huaj apo personit pa shtetësi, me kërkesën e tij, i cili i plotëson kriteret e refugjatit të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1.10 të këtij ligji.</p> <p>2. Personat të cilëve iu është dhënë azili në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, do t’iu lëshohet lejeqëndrimi në pajtim me Ligjin për të Huajt.</p>	<p>which have been engaged in by the asylum seeker since he left the country of origin, in particular where it is established that the activities relied upon constitute the expression and continuation of convictions or orientations held in the country of origin.</p> <p>3. Without prejudice to the Geneva Convention, Republic of Kosovo may determine that an asylum seekers who files a subsequent asylum seekers shall normally not be granted refugee status, if the risk of persecution is based on circumstances which the asylum seeker has created by his own decision since leaving the country of origin.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Granting of asylum</p> <p>1. The Republic of Kosovo grants asylum to a foreign national or stateless person, at their request, who fulfils the criteria layed down in Article 2, subparagraph 1.10 of this Law</p> <p>2. Persons granted asylum in accordance with paragraph 1 of this article shall be issued residence in accordance with the Law of Foreigners</p>	<p>aktivnostima u kojima tražioc azila bio je angažovan sa vreme napuštanja zemlje porekla, naročito kada se utvrdi da ti aktivnosti predstavljaju izraz i nastavak kažnja ili orijentacije u zemlji porekla.</p> <p>3. Bez prekršanja Ženevske konvencije, Republika Kosova može utvrditi da tražioc azila koji podnese naknadni zahtev obično ne dobija status izbeglice, ako opasnost od progona se zasniva na okolnostima koje tražioc je stvorio po sopstvenom odlukom od vreme napuštanja zemlje porekla.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Odobrenje azila</p> <p>1. Republika Kosovo odobri azil stranom državljanom ili licu bez državljanstva, na njegov zahtev, koji ispunjava kriterijume u Članu 2, tački 1.10 ovog Zakona.</p> <p>2. Licama kojima je odobren azil u skladu sa stavom 1. ovog člana izdaje boravište u skladu sa Zakonom o strancima.</p>
---	---	---



Neni 7 Përjashtimi nga azili	Article 7 Exclusion from Asylum	Član 7 Isključenje iz Azila
<p>1. E drejta për azil nuk do t'i njihet një personi, për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se ai/ajo:</p> <p>1.1. Ka kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit në siç definohet në aktet ndërkombëtare të hartuara për të paraparë dispozita për krime të tilla;</p> <p>1.2. Ka kryer krim serioz jo-politik jashtë Republikës së Kosovës para pranimit tij apo saj si refugjat, në atë vend si refugjat;</p> <p>1.3. Është fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e Kombeve të Bashkuara, siç parashihet në preambulë dhe nenin 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.</p> <p>2. Paragrafi 1 i këtij neni, zbatohet ndaj personave të cilet nxisin apo në mënyrë tjetër marrin pjesë në kryerjen e krimeve ose akteve të lartcekura.</p> <p>3. Azili nuk do t'iu lejohet personave të cilët tashmë gëzojnë ndihmën ose mbrojtjen e organeve dhe agjencive të Kombeve të</p>	<p>1. The right to asylum will not be granted to a person, about whom there are serious reasons for considering that he/she has:</p> <p>1.1. Committed a crime against peace, war crimes or crimes against humanity as defined in the international instruments drawn up to make provision in respect of such crimes;</p> <p>1.2. committed a serious non-political crime outside the Republic of Kosovo prior to his or her admission as a refugee, to that country as a refugee</p> <p>1.3. been guilty of acts contrary to the purposes and principles of the United Nations as set out in the Preamble and Articles 1 and 2 of the Charter of the United Nations.</p> <p>2. Paragraph 1 of this Article will be applied to persons who incite or in other ways participate in committing the crimes or acts mentioned therein.</p> <p>3. Asylum will not be granted to persons who at present receiving the assistance or protection of United Nations bodies and</p>	<p>1. Pravo na azil se neće odobriti licu, za koga postoji osnovana ozbiljna sumnja da je on / ona:</p> <p>1.1. počinio zločin protiv mira, ratne zločine ili zločine protiv kako je definisano u međunarodnim aktima namenjenih odredbama predviđenim za takve zločine;</p> <p>1.2. počinio bilo kakav ozbiljan nepolitički zločin van Republike Kosova, prije priznavanja statusa izbeglice, u toj zemlji kao izbeglice;</p> <p>1.3. je kriv za dela koja su u suprotnosti sa ciljevima i načelima Ujedinjenih nacija, kao što je predviđeno u preambuli i člana 1. i 2. Povelje Ujedinjenih Nacija.</p> <p>2. Stav 1. ovog Člana će se primenjivati na lica koja podstiče ili na drugi način učestvuje u izvršenju zločina ili gore pomenutih akcija.</p> <p>3. Azil se neće dodeliti licima koja trenutno uživaju podršku ili zaštitu organa ili</p>



<p>Bashkuara, përveç mbrojtjes ose ndihmës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatë. Kur një mbrojtje ose ndihmë e tillë ka pushuar për çfarëdo arsye, pa u vendosur definitivisht pozita e këtyre personave në pajtim me rezolutat relevante të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, këta persona në bazë të fakteve (ipso facto) kanë të drejtë të përfitojnë nga ky ligj.</p> <p>4. Azili nuk do t'u lejohet personave, për të cilët të drejtat dhe detyrimet e ngjashme si shtetas të Kosovës janë të njohura nga shteti i Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Dhënia e mbrojtjes plotësuese</p> <p>1. Republika e Kosovës ia ofron mbrojtjen plotësuese shtetasit, të huaj apo personit pa shtetësi i cili nuk i përmbush kriteret e përcaktimit të statusit të refugjatit, por i plotëson kriteret e përcaktuara në përkufizimin e mbrojtjes plotësuese të parapara në nenin 2, paragrafi 1.12 të këtij ligji.</p> <p>2. Sa më parë që është e mundur pasi që statusi i tyre është akorduar, Ministria do t'u lëshojnë përfituesve të statusit të mbrojtjes</p>	<p>agencies, other than the protection or assistance of the High Commissioner of the United Nations for refugees. When such protection or assistance has ceased for any reason, without the position of these persons being definitively settled in accordance with the relevant resolutions adopted by the United Nations General Assembly, these persons according to the facts (ipso facto) shall be entitled to benefit from this law.</p> <p>4. Asylum is not allowed to persons whose rights and duties as Kosovo citizens are recognized by the state of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Granting subsidiary protection</p> <p>1. The Republic of Kosovo grants subsidiary protection to foreign nationals or stateless persons who do not qualify for refugee status, but do meet specified criteria defining subsidiary protection, as set out in Article 2, subparagraph 1.12 of this Law.</p> <p>2. As soon as possible after the status has been granted, Ministry shall issue to beneficiaries of subsidiary protection</p>	<p>agencija Ujedinjenih Nacija, osim zaštite ili pomoći Visokog Komesarijata Ujedinjenih Nacija za izbeglice. Kada se takva pomoć ili zaštita završava iz bilo kog razloga, bez rešavanja položaja ovih lica u skladu sa relevantnim rezolucijama odobrenih od strane Generalne Skupštine Ujedinjenih Nacija, ova lica u skladu sa činjenicama (ipso facto) imaju pravo da imaju korist od ovog zakona.</p> <p>4. Azil se ne dozvoljava licima čija su prava i obaveze kao građani Kosova priznati od strane države Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Odobranje Subsidijarne Zaštite</p> <p>1. Republika Kosovo odobrava dodatnu zaštitu stranim državljanima ili licima bez državljanstva koji ne ispunjavaju uslove za sticanje statusa izbeglice, ali koji ispunjavaju propisane kriterijume koji definišu dodatnu zaštitu, kako je navedeno u Članu 2, tački 1.12 ovog Zakona.</p> <p>2. Kao što je pre moguće, nakon status je odobren, Ministarstvo će izdati korisnicima</p>
--	---	---



<p>plotësuese një leje banimi e cila duhet të jetë e vlefshme së paku një vit dhe e përsëritshme, përveç nëse arsyet imponuese të sigurisë shtetërore apo të rendit publik kërkojnë ndryshe.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Përfshirja nga mbrojtja plotësuese</p> <p>1. E drejta për mbrojtje plotësuese nuk do t'i njihet personit, për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se ai/ajo:</p> <p>1.1. Ka kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit në kuptim të dispozitave ndërkombëtare që përcakton këto krime;</p> <p>1.2. Ka kryer krime të rënda të dënueshme;</p> <p>1.3. Është fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e Kombeve të Bashkuara, siç parashihet në preambulë dhe nenin 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;</p> <p>1.4. Paraqet rrezik për bashkësinë ose për sigurinë e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Paragrafi 1 i këtij neni, zbatohet ndaj</p>	<p>status a residence permit which must be valid for at least one year and renewable, unless compelling reasons of national security or public order otherwise require.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Exclusion from subsidiary protection</p> <p>1. The right to subsidiary protection will not be granted to a person, about whom there are serious reasons for considering that he/she:</p> <p>1.1 has committed crimes against peace, war crimes or crimes against humanity according to the international provisions that define these crimes;</p> <p>1.2 has committed serious and punishable crimes;</p> <p>1.3 guilty of acts contrary to the purposes and principles of the United Nations as set out in the Preamble and Articles 1 and 2 of the Charter of the United Nations;</p> <p>1.4 constitutes a danger to the community or to the security of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Paragraph 1 of this Article is applied to</p>	<p>statusa zavisne zaštite dozvole za boravak koja traba da važi najmanje godinu dana i sa mogućnošću produženja, osim ako jaki razlozi nacionalne bezbednosti ili javnog poretka zahtevaju drugačije.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Isključenje iz supsidijarne zaštite</p> <p>1. Pravo na supsidijarnu zaštitu neće biti odobreno licu, za koga postoji ozbiljna osnovana sumnja da je on / ona:</p> <p>1.1. Počinili zločine protiv mira, ratne zločine ili zločine protiv čovečnosti u skladu sa međunarodnim propisima koji definišu ove zločine;</p> <p>1.2. Počinili teška krivična i kažnjiva dela;</p> <p>1.3. je kriv za dela koja su u suprotnosti sa ciljevima i načelima Ujedinjenih nacija, kao što je navedeno u preambuli i člana 1 i 2 Povelje Ujedinjenih nacija;</p> <p>1.4. predstavlja opasnost za zajednicu ili bezbednosti Republike Kosova.</p>
--	---	---



<p>personave të cilët nxisin apo në mënyrë tjetër marrin pjesë në kryerjen e krimeve ose akteve të lartcekura.</p> <p>3. Mbrojtja plotësuese nuk do t'i jepet një personi i cili ka kryer një apo më tepër vepra penale para se të hyjë në Republikën e Kosovës jashtë fushëveprimtarisë së paragrafit 1, të cilat vepra penale do të ishin të dënueshme me burgim nëse do të kryheshin në Republikën e Kosovës dhe nëse ai apo ajo e lëshon vendin e tij apo saj të origjinës, vetëm për t'iu shmangur sanksioneve që rezultojnë nga këto krime.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Hyrja në Republikën e Kosovës</p> <p>1. Shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi të cilët deklarojnë qëllimet e tyre për parashtrimin e kërkesës për azil në Republikën e Kosovës, do të trajtohen si azilkërkues në pajtim me këtë ligj, pra do t'ju lejohet të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Ndihma për azilkërkuesit</p> <p>1. Azilkërkuesi mund të kërkojë azil në një gjuhë të cilën ai ose ajo e kupton.</p>	<p>persons who incite or in another manner participate in committing crimes or acts mentioned therein.</p> <p>3. Subsidiary protection shall not be granted to a person if he or she, prior to his or her admission to the Republic of Kosovo, has committed one or more crimes outside the scope of paragraph 1 which would be punishable by imprisonment, had they been committed in the Republic of Kosovo, and if he or she left his or her country of origin solely in order to avoid sanctions resulting from those crimes.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Entry into the Republic of Kosovo</p> <p>1. Foreign nationals or stateless persons who declare their intention to apply for asylum in the Republic of Kosovo will be treated as asylum seekers in accordance with this Law, and thus will be allowed to enter into the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Assistance for Asylum seekers</p> <p>1. The asylum seeker shall be able to apply for asylum in a language which he</p>	<p>2. Stav 1. ovog Člana primenjuje se na lica koja podstiču ili na drugi način učestvuju u izvršenju zločina ili gore pomenutih akata.</p> <p>3. Dodatna zaštita se neće odobriti licu koje je počinilo jedno ili više krivičnih dela pre ulaska u Republiku Kosovo, van delokruga stava 1 ovog Člana, a koja krivična dela će biti kažnjiva zatvorom, ako su izvršena u Republici Kosovo i ako on ili ona napusti zemlju porekla, samo da izbegne sankcije koje proističu iz tih zločina.</p> <p style="text-align: center;">Član 10. Ulazak u Republiku Kosovo</p> <p>1. Strani državljani ili lica bez državljanstva koji izjavljuju svoju nameru da podnesu zahtev za azil u Republici Kosovo će se tretirati kao tražioci azila u skladu sa ovim zakonom, i na taj način će biti omogućeni da uđu na teritoriju Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Pomoć azilantima</p> <p>1. Tražioc azila će moći da podnese zahtev</p>
--	--	---



<p>2. Azilkërkuesi në një afat 15 ditor që nga paraqitja e kërkesës për azil do të informohet në një gjuhë të cilën e kupton lidhur me procedurën e azilit, të drejtat dhe detyrimet në procedurën e tillë, si dhe për të drejtën të kontaktoj UNHCR-në dhe ndonjë Organizatë Joqeveritare të cilat iu ofrojnë ndihmë azilkërkuesëve.</p> <p>3. Azilkërkuesi ka të drejtë të zgjedh një përfaqësues, i cili do ta ndihmoj dhe përfaqësoj atë gjatë procedurës për përcaktimin e azilit, me shpenzime të azilkërkuesit.</p> <p>4. Përfaqësuesi i azilkërkuesit si dhe përfaqësuesi i Zyrës së UNHCR-së, kanë të drejtë të kontaktojnë azilkërkuesin në çdo kohë dhe në secilën fazë të procedurës për përcaktimin e azilit.</p> <p>5. Azilkërkuesi ka të drejtë të flas me përfaqësuesin e tij ose përfaqësuesin e UNHCR-së në çdo kohë, si dhe të jetë i informuar për këtë të drejtë.</p> <p>6. Përfaqësuesi gëzon qasje në informacion në dosjen e azilkërkuesit, siç i lejohet</p>	<p>or she understands.</p> <p>2. Within a period of 15 days from the submission of their application for asylum, the asylum seeker will be informed in a language that they understand, about the procedure of asylum, the rights and duties of such a procedure, as well as the right to contact UNHCR and any Non-Governmental Organization which offers assistance to asylum seekers.</p> <p>3. The asylum seeker shall have the right to choose a representative who will assist them and represent them during the process of deciding on asylum, at the expense of the asylum seeker.</p> <p>4. The representative of the asylum seeker and the representative of the UNHCR office have the right to contact the asylum seeker at all times and in each phase of the procedure deciding on asylum.</p> <p>5. The Asylum seeker has the right to talk with their representative, or with the UNHCR representative at any time and to be informed of this right.</p> <p>6. The representative shall enjoy access to such information in the asylum seeker's</p>	<p>za azil na jeziku koji on ili ona razume.</p> <p>2. U roku od 15 dana od predaje zahteva za azil, tražilac azila će biti obavješten na jeziku koji razume, o postupku azila, prava i obaveze takvog postupka, kao i pravo da se obrati UNHCR-u i bilo kojoj nevladinoj organizaciji koja pruža pomoć tražiocima azila.</p> <p>3. Lice koje traži azil ima pravo da izabere predstavnika koji će im pomoći i koji će ih predstavljati u procesu odlučivanja o azilu, na račun tražioca azila.</p> <p>4. Predstavnik tražioca azila i predstavnik kancelarije UNHCR-a imaju pravo da kontaktiraju tražioca azila u svakom trenutku i u svakoj fazi postupka odlučivanja o azilu.</p> <p>5. Trazioc azila ima pravo da razgovara sa njihovim predstavnikom, ili predstavnikom UNHCR-a u bilo kom trenutku i da bude informisan o ovom pravu.</p> <p>6. Poslanik ima pristup na informacije u</p>
---	---	--



<p>autoritetit të përcaktuar për të shqyrtuar kërkesën për azil, për aq sa është i rëndësishëm informacioni për shqyrtimin e kërkesës.</p> <p>7. Përjashtimisht përfaqësuesi nuk do e gëzoj të drejtën në dosjen e azilkërkuetit kur zbulimi i informatave ose burimeve do të rrezikonte sigurinë kombëtare, sigurinë e organizatave apo personit/personave që ofrojnë informacionin, sigurinë e personit/personave të cilëve u referohet informacioni ose kur interesat e hetimeve në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të azilit nga organi kompetent ose marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, do të rrezikoheshin. Në këto raste, qasja në informata ose burime në fjalë do të jetë në dispozicion të organit kompetent me përjashtim kur qasja e tillë është përjashtuar për shkak të sigurisë kombëtare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Gjuha e procedurës dhe e drejta për përkthyes</p> <p>1. Në rastet kur azilkërkueti nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, organi kompetent i siguron shërbimet e</p>	<p>file as is liable to be examined by the authorities responsible for examination of request for asylum insofar as the information is relevant to the examination of the application</p> <p>7. As an exception, the representative shall not enjoy access in the applicant's file where disclosure of information or sources would jeopardise national security, the security of the organisations or person(s) providing the information or the security of the person(s) to whom the information relates or where the investigative interests relating to the examination of applications of asylum by the competent authority or the international relations of Republic of Kosovo would be compromised. In these cases, access to the information or sources in question shall be available to the competent authority, except where such access is precluded in cases of national security.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Language of the procedure and the right to a translator</p> <p>1. In cases where the asylum seeker does not understand the language in which procedures are done, the Competent</p>	<p>dosije tražioca azila koja mu se dozvoli od strane organa zaduženih za ispitivanje zahteva za azil ukoliko je informacija relevantna na ispitivanja prijave.</p> <p>7. Izuzetno, predstavnik nema pristup u dosije tražioca gde otkrivanje informacija ili izvori bi ugrožilo nacionalnu bezbednost, bezbednost organizacija ili lice(a) koji pruže informacije ili bezbednosti lice(a) na koje se informacija odnosi ili kada istražni interesi koji se odnose na ispitivanje primene azila od strane nadležnog organa ili međunarodne odnose Republike Kosovo će biti ugrožena. U ovim slučajevima, pristup na informacije i izvore gore navedene će biti dostupna nadležnom organu, osim ako takav pristup je isključen u slučajevima nacionalne bezbednosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Jezik postupka i pravo na prevodioca</p> <p>1. U slučajevima u kojima tražilac azila ne razume jezik na kome se obavlja</p>
---	---	--



<p>përkthimit me qëllim që t'i sigurohet procedura në një gjuhë në të cilën konsiderohet se e kupton. Përkthyesi do të jetë i detyruar të mbaj sekretin profesional.</p> <p>2. Në raste të veçanta, nëse është e mundur azilkërkuesit do t'i sigurohet një përkthyes i të njëjtës gjini.</p> <p>3. Azilkërkuesi ka të drejtë të angazhoj një përkthyes sipas vullnetit të vet, me kusht që ky fundit të mos jetë azilkërkues.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Femrat azilkërkuese</p> <p>Azilkërkueset femra kanë të drejtë që procedurën e azilit ta zhvilloj zyrtarja, në pajtim me mundësitë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Fëmijët e pashoqëruar</p> <p>1. Azilkërkuesit fëmijë të pashoqëruar do t'i caktohet zyrtari për shërbimet sociale i caktuar nga Qendra për Punë Sociale në kohën sa më të shkurtë të mundur, si përfaqësues i fëmijës së pashoqëruar në mënyrë që të përfaqësoj ose ta ndihmoj të</p>	<p>Authority will provide translation services to ensure that the process occurs in a language he or she is considered to understand. The translator will be bound by professional confidentiality.</p> <p>2. In special cases, if it is possible the asylum seeker will be provided with a translator of the same gender.</p> <p>3. The asylum seeker has the right to engage a translator as long as the latter is not also an asylum seeker.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Women asylum seekers</p> <p>Where possible, women asylum seekers have the right to their asylum claim being processed by a woman official.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Unaccompanied child</p> <p>1. Unaccompanied child asylum seekers will be assigned an official for social services appointed from the Center for Social Affairs as soon as is it possible as a representative of the unaccompanied child in order to represent and/or assist the</p>	<p>procedura, nadležni organ će pružati usluge prevođenja kako bi se osiguralo da se proces odvija na jeziku koji on ili ona razume. Prevodilac će biti obavezan profesionalnom poverljivošću.</p> <p>2. U posebnim slučajevima, ukoliko je moguće, tražilocu azila će se obezbediti prevodioc istog pola.</p> <p>3. Tražioc azila ima pravo da angažuje prevodioca sve dok prevodioc nije takođe tražioc azila.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Žene tražioci azila</p> <p>Gde je to moguće, žene tražioci azila imaju pravo da svoj zahtev za azil bude obrađen od žene zvaničnika.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Maloletnici bez pratnje</p> <p>1. Maloletnicima bez pratnje koji su tražioci azila će biti dodeljen službenik za socijalne usluge imenovan iz Centra za Socijalni Rad što pre je moguće kao predstavnik deteta bez pratnje cilju</p>
--	--	--



<p>miturin e pashoqëruar me qëllim të shqyrtimit të kërkesës për azil. Në asnjë rrethanë fëmija i pashoqëruar nuk mund të merret në pyetje pa qenë i shoqëruar nga zyrtari për shërbimet sociale.</p> <p>2. Organi kompetent duhet të marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës me rastin e implementimit të këtij neni.</p> <p>3. Zyrtarit për shërbimet sociale për fëmijë, do t'i ipet mundësia për ta informuar fëmijen e pa shoqëruar për kuptimin dhe pasojat eventuale të intervistës personale dhe, kur është e nevojshme si ta përgatis vetën për intervistë personale. Zyrtari për shërbimet sociale për fëmijë, do të lejohet të marrë pjesë në intervistë dhe ka të drejtë të parashtrij pyetje ose të paraqes komente brenda kornizës së përcaktuar nga zyrtari intervistues.</p> <p>4. Në rastet kur fëmija i pashoqëruar do të intervistohet lidhur me kërkesën e tij për azil, kjo intervistë do të zhvillohet nga personi i cili ka njohuri të domosdoshme lidhur me nevojat e veçanta të fëmijës, dhe vendimi lidhur me kërkesën për azil po ashtu duhet të merret nga personi i cili i ka njohuritë e domosdoshme për nevojat e veçanta të fëmijës.</p>	<p>unaccompanied child with respect to the examination of the application. In no circumstances an unaccompanied child cannot be interrogated without being accompanied from the Official for the Social Affairs.</p> <p>2. The best interests of the child shall be a primary consideration for competent Authority when implementing this Article.</p> <p>3. The opportunity shall be ensured to the official for social affairs to inform the unaccompanied child about the meaning and possible consequences of the personal interview and, where appropriate, how to prepare himself/herself for the personal interview. The official for social affairs shall be allowed to be present at that interview and to ask questions or make comments, within the framework set by the person who conducts the interview.</p> <p>4. If an unaccompanied child has a personal interview on his/her application for asylum, that interview is conducted by a person who has the necessary knowledge of the special needs of child the determining authority on the application of an unaccompanied child.</p>	<p>zastupanja ili pomoći detetu bez pratnje radi razmatranja zahteva za azil. Ni u kom slučaju, dete bez pratnje ne može biti saslušan bez pratnje zvaničnika za Socijalna Pitanja.</p> <p>2. Nadležni Organ je dužan da uzme u obzir najbolje interese maloletnika prilikom sprovođenja ovog člana.</p> <p>3. Prilika će se obezbediti zvaničniku za socijalna pitanja za decu, da informiše dete bez pratnje za smisao i moguće posledice ličnog intervjuja i, prema potrebi, kako da se pripremi za lični razgovor. Zvaničniku za socijalna pitanja za decu će biti dozvoljeno da prisustvuje tom razgovoru i da postavlja pitanja ili daje komentare, u okviru utvrđenom od strane lica koja obavlja razgovor.</p> <p>4. Ako dete bez pratnje ima lični intervju na njegovu molbu za azil, taj intervju se obavlja od strane lica koje ima potrebna znanja o posebnim potrebama deteta, I odluka u vezi sa zahtevom za azil takode treba da se donese od osobe koja ima neophodna znanja za posebne potrebe deteta.</p>
---	---	---



<p>5. Pas njohjes së statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtjes së përkohshme fëmijës të pashoqëruar i caktohet kujdestari për fëmijë.</p> <p>6. Ministria është e obliguar të filloj përpjekjet për të gjetur sa më shpejt prindërit apo të afërmit e tjerë të ngushtë të fëmijës të pashoqëruar në bashkëpunim me organizatat relevante.</p> <p>7. Ministria do të sigurohet që fëmijët e pashoqëruar të jenë të vendosur qoftë:</p> <p>7.1. Me të afërmit e rritur; apo</p> <p>7.2. Me ndonjë familje birësuese; apo</p> <p>7.3. Në qendra të specializuara për akomodim të të miturve; apo</p> <p>7.4. Në akomodim tjetër të përshtatshëm për të mitur.</p> <p>8. Në këtë kontekst, mendimi i fëmijës do të merret parasysh në pajtim me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij apo të saj.</p> <p>7. Ata që punojnë me fëmijët e pashoqëruar duhet të kenë marrë ose duhet të marrin trajnim të përshtatshëm në lidhje me nevojat</p>	<p>5. After the recognition of the refugee status, subsidiary protection and the temporary protection, a legal custodian from the Center for Social Affairs for child is appointed to the unaccompanied child.</p> <p>6. Ministry is obliged to start tracing parents or close relatives of unaccompanied child asylum seeker in cooperation in relevant organizations.</p> <p>7. The ministry shall ensure that unaccompanied minors are placed either:</p> <p>7.1. With adult relatives; or</p> <p>7.2. With a foster family; or</p> <p>7.3. in centres specialised in accommodation for minors; or</p> <p>7.4. in other accommodation suitable for minors.</p> <p>8. In this context, the views of the child shall be taken into account in accordance with his or her age and degree of maturity.</p> <p>7. Those working with unaccompanied child shall have had or receive appropriate training concerning their specific needs,</p>	<p>5. Nakon priznavanja statusa izbeglice, subsidiarne zaštite i privremene zaštite, detetu bez pratnje određuje se staratelj za decu.</p> <p>6. Ministarstvo će učiniti razumne napore da pronađe roditelje ili druge bliske rođake maloletnika bez pratnje u saradnji sa relevantnim organizacijama.</p> <p>7. Ministarstvo će osigurati da se Maloletnici bez pratnje su postavljeni:</p> <p>7.1 Sa odraslim rođacima; ili</p> <p>7.2 U hraniteljsku porodicu; ili</p> <p>7.3 . u centrima specijalizovane za smeštaj maloletnika; ili</p> <p>7.4 u drugi smeštaj pogodan za maloletnike.</p> <p>8. U tom kontekstu, stav deteta se uzima u obzir u skladu sa njihovog uzrasta i stepena zrelosti</p> <p>7. Oni koji rade sa detetom bez pratnje treba da završe odgovarajuću obuku u</p>
--	--	--



<p>specifike të tyre, dhe duhet të respektojnë parimin e konfidencialitetit, në lidhje me ndonjë informacion që ata mund të marrin gjatë punës së tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Azilkërkuesit me të meta mentale</p> <p>Për azilkërkuesit me aftësi të zvogëluara mentale do t'i caktohet një përfaqësues para fillimit të procedurës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Personat me nevoja të veçanta</p> <p>1. Qeveria do t'iu kushtoj trajtim dhe kujdes të veçantë personave me nevoja të veçanta, veçanërisht fëmijëve, fëmijëve të pashoqëruar, personat e moshuar, personat e paaftë, gratë shtatëzëna, prindërit e vetëm me fëmijë, personat të cilët kanë qenë viktimat të torturës, dhunimit, apo ndonjë formë tjetër serioze të dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale.</p> <p>2. Nevoja të veçanta sipas këtij ligji do të përcaktohen në bazë të vlerësimit individual të secilit azilkërkues, refugjat, person nën mbrojtjen plotësuese apo personat nën mbrojtje të përkohshme.</p>	<p>and shall be bound by the confidentiality principle in relation to any information they obtain in the course of their work.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Asylum seekers with limited mental capacities</p> <p>Asylum seekers with limited mental capacities will be assigned a representative before the process begins.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Persons with special needs</p> <p>1. The Government will pay special attention to the treatment and care of persons with special needs, particularly minors, unaccompanied minors, the elderly people, disabled people, pregnant women, single parents with just one child minor, and persons who have been victims of torture, rape or another serious form of psychological, physical and sexual violence.</p> <p>2. According to this law, special needs will be defined on the basis of an individual assessment of each asylum seeker, refugee or person under subsidiary protection or persons under temporary</p>	<p>skladu sa njihovim specifičnim potrebama, a biće obavezan princip poverljivosti u odnosu na bilo koje informacije koje dobije u toku svog rada</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Tražiocia azila sa ograničenim mentalnim sposobnostima</p> <p>Tražiocima azila sa ograničenim mentalnim sposobnostima će biti dodeljen predstavnik pre nego što počne proces.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Osobe sa posebnim potrebama</p> <p>1. Vlada će obratiti posebnu pažnju lečenju i nezi licima sa posebnim potrebama, posebno deci, deca bez pratnji, starijim osobama, invalidima, trudnicama, samohranim roditeljima sa samo jednim maloletnim detom, i lica koja su bila žrtve torture, silovanja ili drugih ozbiljnih oblika psihičkog, fizičkog i seksualnog nasilja.</p> <p>2. Prema ovom zakonu, posebne potrebe će se definisati na osnovu individualne procene svakog tražioca azila, izbeglice ili lica pod supsidijarnom zaštitom ili lica pod</p>
--	---	---



<p>3. Azilkërkuesit, refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese apo personat nën mbrojtje të përkohshme me nevoja të veçanta, do të kenë trajtim të veçantë në pajtim me nevojat e tyre specifike me rastin e akomodimit, ofrimit të kushteve të veçanta të pranimi, trajtimin e nevojshëm mjekësor, këshillimin e nevojshëm psikosocial.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Qendrimi dhe liria e lëvizjes</p> <p>1. Azilkërkuesit mund të lëvizin lirshëm në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Republika e Kosovës mund të vendos lidhur me kufizimin e lëvizjes për arsye të interesit publik ose kur është e nevojshme për shqyrtim të shpejtë dhe vëzhgimin efektiv të kërkesës së tij ose saj.</p> <p>3. Kur paraqitet e nevojshme, për shembull për arsye ligjore ose për arsye të rendit publik, Republika e Kosovës mund t'ia kufizoj lirinë e lëvizjes në përputhje me legjislacionin kombëtar.</p> <p>Azilkërkuesi nuk duhet të kërkoj leje për të kryer takimet me autoritetet ose gjykatat,</p>	<p>protection.</p> <p>3. Asylum seekers, refugees, persons under subsidiary protection or persons under temporary protection with special needs will be given special treatment in accordance to their specific needs in the event of accommodation, provision of special standards for admission, necessary medical treatment, and required psycho-social counsel.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Residence and freedom of movement</p> <p>1. Asylum seekers may move freely within the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Republic of Kosovo may decide on the asylum seekers residence for reasons of public interest, public order or, when necessary, for the swift processing and effective monitoring of his or her application.</p> <p>3. When it proves necessary, for example for legal reasons for reasons of public order, Republic of Kosovo may confine an asylum seeker to a particular place in accordance national law.</p> <p>4. Asylum seekers shall not require permission to keep appointments with</p>	<p>privremenom zaštitom.</p> <p>3. Tražioci azila, izbeglice, lica pod supsidijarnom zaštitom ili lica pod privremenom zaštitom sa posebnim potrebama će imati poseban tretman u skladu sa njihovim specifičnim potrebama u slučaju smeštaja, obezbeđivanje posebnih standarda za prijem, neophodan medicinski tretman, i potrebni psiho-socijalni branilac.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Ograničenje kretanja</p> <p>1. Tražioci azila mogu slobodno da se kreću na teritoriji Republike Kosova.</p> <p>2. Republika Kosovo može da odlučuje o ograničenju kretanja zbog javnog interesa ili kada je neophodno hitno razmatranje i efikasno praćenje njegovog zahteva.</p> <p>3. Kada je potrebno, na primer, iz pravnih razloga ili iz razloga javnog poretka, Republika Kosovo može ograničiti slobodu kretanja u skladu sa nacionalnim zakonodavstvom.</p> <p>4. Trazioc azila ne bi trebalo da traži</p>
---	---	---



<p>kur paraqitja e tij/ saj është e nevojshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Roli i UNHCR- së</p> <p>1. Organet shtetërore do ta lejojnë UNHCR - në:</p> <p>1.1. Të ketë qasje tek azilkërkuesit, duke përfshirë edhe ata nën arrest, në aeroport;</p> <p>1.2. Të ketë qasje në informata, te kërkesat individuale për azil, në zhvillimin e procedurave dhe në vendimet e marra duke siguruar që azilkërkuesi ka shprehur pajtimin;</p> <p>1.3. Të paraqes pikëpamjet e veta, si zbatim i përgjegjësive mbikëqyrëse sipas nenit 35 të Konventës së Gjenevës ndaj cilitdo organ kompetent, lidhur me kërkesat individuale për azil në çdo fazë të procedurës.</p> <p>2. Paragrafi 1 i këtij neni, do të zbatohet gjithashtu për organizatën e cila punon në emër të UNHCR-së në territorin e Republikës së Kosovës sipas një marrëveshjeje me Qeverinë e Kosovës.</p>	<p>authorities and courts if his or her appearance is necessary.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 The role of the UNHCR</p> <p>1. State authorities will allow UNHCR:</p> <p>1.1. to have access to asylum seekers, including those in detention and in airport;</p> <p>1.2 to have access to information on individual applications for asylum, on the course of the procedure and on the decisions taken, provided that the asylum seeker agrees thereto;</p> <p>1.3. to present its views, in the exercise of its supervisory responsibilities under Article 35 of the Geneva Convention, to any competent authorities regarding individual applications for asylum at any stage of the procedure.</p> <p>2. Paragraph 1 of this article shall also apply to an organisation which is working in the territory of the Republic of Kosovo on behalf of the UNHCR pursuant to an agreement with the Government of Kosovo.</p>	<p>dozvolu da vodi sastanke sa organima ili sudovima kada je to neophodno.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Uloga UNHCR-a</p> <p>1. Državni organi će omogućiti UNHCR-u:</p> <p>1.1. Da imaju pristup podnosiocima zahteva za azil, uključujući i one u pritvoru i na aerodromu;</p> <p>1.2. Da imaju pristup informacijama o pojedinačnim zahtevima za azil, u toku postupka i o odlukama, pod uslovom da podnosilac zahteva za azil se slaže sa tim;</p> <p>1.3. Da iznesu svoje stavove, u vršenju svojih nadzornih odgovornosti na osnovu člana 35 Ženevske Konvencije, svim nadležnim organima u vezi sa pojedinačnim zahtevima za azil u bilo kojoj fazi postupka.</p> <p>2. Stav 1. ovog člana odnosi se i na organizaciju koja radi na teritoriji Države Članice, u ime UNHCR-a u skladu sa ugovorom sa Vladom Kosova.</p>
--	---	--



<p style="text-align: center;">KREU II</p> <p style="text-align: center;">TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AZILKËRKUESËVE, PERSONAVE ME STATUS REFUGJATI DHE PERSONAVE NËN MBROJTJE PLOTËSUESE</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Të drejtat e azilkërkuesëve</p> <p>1. Azilkërkuesi ka të drejtë:</p> <p>1.1. Të qëndroj në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.2. Të ketë kushtet themelore të jetesës;</p> <p>1.3. Kujdesin shëndetësor;</p> <p>1.4. Ndhimën sociale themelore;</p> <p>1.5. Ndhimën ligjore pa pagesë;</p> <p>1.6. Të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit e mitur;</p> <p>1.7. Të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar;</p> <p>1.8. Të drejten për punësim dhe të</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER II</p> <p style="text-align: center;">THE RIGHTS AND DUTIES OF ASYLUM SEEKERS, THE PERSONS WITH THE REFUGEE STATUS AND PERSONS UNDER SUBSIDIARY PROTECTION</p> <p style="text-align: center;">Article 19 The rights of asylum seekers</p> <p>1. The asylum seeker has the right:</p> <p>1.1. To reside in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. To basic living conditions;</p> <p>1.3. To basic health care;</p> <p>1.4. To basic social assistance;</p> <p>1.5. To free legal assistance;</p> <p>1.6. To education for minor asylum seekers;</p> <p>1.7. To freedom of thought and religious belief;</p> <p>1.8. To employment and professional</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE II</p> <p style="text-align: center;">PRAVA I OBAVEZE TRAŽIOCA AZILA, LISE SA STATUSOM IZBEGLICEI LICA POD SUPSIDIJARNOM ZAŠTITOM</p> <p style="text-align: center;">Član 19. Prava tražioca azila</p> <p>1. Tražioc azila ima pravo:</p> <p>1.1. Da boravi u Republici Kosovo;</p> <p>1.2. Na osnovne životne uslove;</p> <p>1.3. Osnovnu zdravstvenu negu;</p> <p>1.4. Na socijalnu pomoć;</p> <p>1.5. Na besplatnu pravnu pomoć;</p> <p>1.6. Obrazovanju za maloletnike tražioce azila;</p> <p>1.7. Na slobodu misli i versko uverenje;</p>
---	--	---



<p>drejtën në trajnime profesionale.</p> <p>Neni 20 E drejta për qëndrim e azilkërkuesit</p> <p>1. Azikërkuesi ka të drejtë të qëndroj në Republikën e Kosovës deri në marrjen e vendimit të formës së prerë.</p> <p>2. Anëtarët e familjes të cilët kanë arritur në Republikën e Kosovës së bashku me azikërkuesin, kanë të drejtë të qëndrojnë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>3. Organi kompetent duhet të ndërmarr masat e nevojshme të mbaj aq sa është e mundur unitetin familjar, ashtu siç është brenda territorit të Republikës së Kosovës nëse azikërkuesëve iu është ofruar strehim.</p> <p>Neni 21 E drejta për kushte themelore të jetesës dhe kushte sociale</p> <p>Azikërkuesit kanë të drejtë në ndihmë financiare që përfshinë strehimin, ushqimin dhe veshëmbathjen të ofruar në mall ose në kupona, dhe një porcion të përditshëm shpenzimesh. Azikërkuesit me nevoja të</p>	<p>training.</p> <p>Article 20 The right to residence of the asylum seeker</p> <p>1. The asylum seeker has the right to reside in the Republic of Kosovo until a final decision is taken.</p> <p>2. Members of the family which have arrived in the Republic of Kosovo together with the asylum seeker have the right to residence, in accordance with paragraph 1 of this article.</p> <p>3. The competent authority shall take appropriate measures to maintain as far as possible family unity as present within the territory of the Republic of Kosovo, if asylum seekers are provided within housing.</p> <p>Article 21 The right to basic living and social conditions</p> <p>Asylum seekers have the right to financial help that include housing, food and clothing, provided in kind, or as financial allowances or in vouchers, and a daily expenses allowance. Asylum seekers</p>	<p>1.8. Na zapošljavanje i stručno usavršavanje.</p> <p>Član 20. Pravo na boravak od tražioca azila</p> <p>1. Tražioc azila ima pravo da boravi u Republici Kosovo do donošenja konačne odluke.</p> <p>2. Članovi porodice koji su stigli u Republici Kosovo, zajedno sa tražiocem azila imaju pravo na boravak, u skladu sa stavom 1. ovog Člana.</p> <p>3. Nadležni organi će preduzeti odgovarajuće mere da održavaju koliko je to moguće, jedinstvo porodice prisutno na teritoriji Republike Kosovo, ukoliko tražiocima azila je obezbeđeno stanovanje.</p> <p>Član 21 Pravo na osnovne životne i socijalne uslove</p> <p>Tražioc azila imaju pravo na osnovne životne uslove koji uključuju, ali nisu ograničeni na: smeštaj, hranu, odeću, i higijenske pakete. Tražiocima azila sa</p>
--	---	--



<p>veçanta do t'iu sigurohen standardet e jetesës në pajtim me nevojat e tyre specifike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Kujdesi shëndetësor</p> <p>1. Azilkërkuesit kanë të drejtë në kujdes shëndetësor e cila përfshinë, kujdesin emergjent shëndetësor dhe trajtimin e sëmundjes.</p> <p>2. Azilkërkuesit të cilët i janë nënshtruar përdhunimit, torturës ose formave të tjera të rënda të dhunës si dhe azilkërkuesëve me nevoja të veçanta, do t'ju afrohet trajtim i nevojshëm mjekësor sipas nevojave specifike dhe pasojave të shkaktuara.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Ndihma ligjore pa pagesë</p> <p>1. Azilkërkuesit i afrohet ndihma juridike falas si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Informata lidhur me të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesëve;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Ndihma në hartimin e ankesave;</p>	<p>with special needs will be provided the living standards in accordance with their specific needs.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Health care</p> <p>1. Asylum seekers have the right to health care, which includes emergency health care and the treatment of illnesses</p> <p>2. Asylum seekers who have been raped or tortured or who have suffered other serious forms of violence, and asylum seekers with special needs, will be provided with the necessary medical treatment according to specific requirements and the effects caused.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Free legal assistance</p> <p>1. Asylum seekers are provided the following free legal assistance:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 Information regarding the rights and duties of asylum seekers;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 Assistance in drafting appeals;</p>	<p>posebnim potrebama će se obezbediti životni standard u skladu sa njihovim specifičnim potrebama.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Zdravstvena nega</p> <p>1. Tražioci azila imaju pravo na zdravstvenu zaštitu, koja uključuje hitnu zdravstvenu negu i lečenje bolesti</p> <p>2. Tražiocima azila koje su silovani ili mučeni ili koji su pretrpeli druge ozbiljne oblike nasilja, i tražiocima azila sa posebnim potrebama, biće obezbijedeni potrebni medicinski tretman u skladu sa specifičnim zahtevima i izazvanim efektima.</p> <p style="text-align: center;">Član 23 Besplatna pravna pomoć</p> <p>1. Tražioci azila dobijaju sledeću besplatnu pravnu pomoć:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 Informacije koje se odnose na prava i obaveze lica koja traže azil;</p>
--	---	---



<p>1.3. Përfaqësimin në procedurë para organit kompetent.</p> <p>2. Ndhimja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do t'i afrohet azilkërkuesit i cili nuk ka mjete të mjaftueshme apo gjëra me vlerë për t'i mbuluar shpenzimet përkatëse.</p> <p>3. Ndhimën sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund ta afrojnë: avokatët apo organizatat për ndihmë të refugjatëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 E drejta në arsim e fëmijëve azilkërkues</p> <p>Azilkërkuesit fëmijë kanë të drejtë në arsimin fillor dhe të mesëm sipas të njëjtave kushte me qytetarët e Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 E drejta në mendimit dhe besimit fetar lirinë e fesë</p> <p>Qeveria e Kosovës do t'iu garantoj azilkërkuesëve të drejtën e ushtrimit dhe lirinë e fesë sipas bindjeve të tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 26</p>	<p>1.3 Representation in procedures before competent authorities.</p> <p>2. Assistance according to paragraph 1 will be provided to the Asylum seeker who does not have sufficient means or valuable assets to cover the respective costs.</p> <p>3. Assistance according to paragraph 1 can be provided by: lawyers or organizations assisting refugees.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 The right to education of asylum seeker minors</p> <p>Asylum seeker minors have the right to elementary and secondary education according to the same conditions as citizens of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 The right to freedom of thought and religious belief</p> <p>The Kosovo Government will guarantee to asylum seekers the right to freely exercise religion according to their convictions</p> <p style="text-align: center;">Article 26</p>	<p>1.2 Pomoć u izradi žalbi;</p> <p>1.3 Zastupanje u postupcima pred nadležnim organima.</p> <p>2. Pomoć iz stava 1. će se obezbediti tražiocu azila koji nema dovoljno sredstava ili vrednog kapitala za pokrivanje odgovarajućih troškova.</p> <p>3. Pomoć iz stava 1. može se obezbediti kroz: advokata ili organizacija koja pružaju pomoć izbeglicama.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Pravo na obrazovanje deca tražioci azila</p> <p>Dete tražioc azila imaju pravo na osnovno i srednje obrazovanje u skladu sa istim uslovima kao i građani Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Pravo na slobodu misli i versko uverenje</p> <p>Vlada Kosova će garantovati tražiocima azila pravo na slobodno vršenje vere u skladu sa svojim uverenjima.</p>
--	--	---



